

## Ndihmë për Viktimat si Pasojë e Dhunës në Kantonet Basel-Stadt dhe Basel-Land

### Fletënjoftim

---

Prej datës 1.1.1993 ka hyrë në fuqi juridike ligji federal për viktimat nga veprimet penale të ushtrimit të dhunës (OHG). Në kuptimin e ligjit, si viktimë llogaritet çdo person, që ka pësuar dëme të shëndetit, të aspektit seksual apo ka pësuar kufizime të dukshme në integritetin psikik. Në raste të veçanta, krahas jush trajtohen edhe të afërmit apo personat e afërt me viktimën dhe njëkohësisht edhe ata mund të shfrytëzojnë kompenzime për përjetime të mundshme.

Si viktimë nga aktet e ushtrimit të dhunës, mundësohen sipas OHG, disa të drejta ligjore:

- Këshillimi falas dhe përkrahja procedurale
- Të drejta në procedurën policore dhe atë gjyqësore kundrejt kryesit të veprës penale
- Ndihmë financiare

Ju keni mundësi që të drejtat tuaja si viktimë sipas OGH-së t'i realizoni edhe pa lajmëruar rastin apo pa ngritur padi penale si dhe pa dashur të ngrini padi penale kundrejt kryesit të aktit.

#### 1. Këshillimi

Ndihma për viktimat në dy kantonet, bartet nga kantonet Basel-Stadt dhe Basel-Land. Këshillimi për viktimat e rasteve të dhunës është falas dhe pavarësisht prej kohës se kur ka ndodhur dhuna. Pra, ju mund të drejtoheni tek ne për këshillim edhe pasi ka kaluar një kohë e gjatë, prej se është përjetuar dhunë. Ju keni edhe atëherë të drejtë për këshillim falas, edhe nëse nuk keni ngritur padi penale ndaj ushtruesit të dhunës, apo edhe nëse kryesi i ushtrimit të dhunës është i panjohur si edhe nëse nuk është ndjekur rasti penalisht apo nuk ka ardhur deri tek një shqiptim i dënimit.

Kjo e drejtë e pakufizuar për këshillim vlenë edhe për të afërmit e viktimës apo për personat e ngushtë me personin që ka përjetuar aktin e dhunës.

Si të punësuar në këshillimoren për viktimat e dhunës për të dy kantonet, Basel-Stadt dhe Basel-Land, i nënshtrohemi mbajtjes së sekretit të punës dhe respektojmë të drejtën e çdo personi, që të vendosë vetë, se a do apo nuk do të ngritet fletëpadi ndaj ushtruesit të aktit të dhunës. Ju keni mundësi të këshilloheni edhe pa treguar emrin apo personalitet tuaja.

#### 2. Të drejtat gjatë procedurës policore dhe procedurës gjyqësore

Si viktimë e ushtrimit të dhunës, ju keni këto të drejta:

- Të kërkonti që të mos keni konfrontim direkt me kryesin e veprës së dhunës. Vetëm në raste të veçanta mundet që të mos merret një gjë e tillë parasysh.
- Që në të gjitha marrjet në pyetje gjatë procedurës sqaruese, keni të drejtë të përcillenit dhe shoqëroheni nga një person i juaj i besueshëm.
- Nëse jeni viktimë e një veprimi të deliktit seksual, deklarinet tuaja për sa i përket sferës intime, keni të drejtë t'i refuzoni apo keni të drejtë të kërkonti që në procedurën hetimore në polici dhe në prokurori të merrëni në pyetje nga një person i po të njejtës gjini si ju.

Ju keni të drejtë dhe mundësi që si paditës apo paditese private të asistoni në procedurën hetimore dhe të bëni edhe kërkesën tuaj për kompenzim material apo kompenzim për dhimbjen shpirtërore të përjetuar nga dhuna. Për atë, duhet që mundësisht me kohë të deponohet kërkesa në polici apo në prokurorinë publike, në formë deklarate apo të ngreni padi penale (në rastet e akteve penale, të cilat ndiqen sipas ligjit, një gjë e tillë duhet të bëhet brenda afatit prej 3 muajve). Nëse hiqet dorë nga pjesëmarrja si paditës privat apo deponimi i kërkesës private për ndjekje penale, tërheqja e sërishme e një kërkesë të tillë nuk është e mundshme.

Gjatë bisedës këshilluese, nga ana jonë, ju informojmë mbi të gjitha të drejtat tuaja të mundshme, pastaj ju ndihmojmë gjithashtu se si të vini deri tek realizimi i të drejtave tuaja dhe ju ofrojmë përkrahjen e avokatëve me pervojë në atë fushë. Për informata edhe më të hollësishme për gjendjen tuaj dhe procedurën e ndjekjes penale, mund të merrni fletënjoftimim "Gjithçka që Duhet të Dini mbi Procedurën e Ndjekjes Penale" ("Was Sie zum Strafverfahren wissen müssen"), gjë që mund ta merrni në këshillimoren për viktimat që kanë përjetuar dhunë, në të dy kantonet, Basel-Stadt dhe Basel-Land, telefoni 061 205 09 10, apo në faqen tonë të internetit nën [www.opferhilfe-bb.ch](http://www.opferhilfe-bb.ch).

#### **Vërejtje e rëndësishme:**

Tek veprat penale, të cilat ndiqen sipas ligjit, vetëm me kërkesë apo padi të personit viktimë, duhet që padia të bëhet **brenda kohës prej 3 muajsh**, duke llogaritur prej kohës se kur ka ndodhur veprimi i ushtrimit të dhunës.

### **3. Ndihmë financiare**

#### **Ndihma urgjente**

Pavarësisht prej kohës se kur ka ndodhur vepra dhe pavarësisht prej gjendjes së të ardhurave, shpenzimet e dëmit si viktimë e një akti të dhunës, mbulohen pa procedurë byrokratike dhe shpejtë, nga ana e Entit për Viktimat e Dhunës së Kantoneve Basel-Stadt dhe Basel-Land. Kështu për shembull, mbulohen të gjitha shpenzimet medicinale, shpenzimet për përkthyes, intervenimin në rastin e krizës, masat e sigurisë, shpenzimet e transportit, sqarimet juridike, apo strehimin e nevojshëm urgjent.

#### **Ndihma për kohë më të gjatë**

Varësisht prej të ardhurave tuaja dhe deri në limitin e përcaktuar me ligj si dhe varësisht prej gjendjes suaj personale, ka mundësi që të mbulohen shpenzimet, të cilat dalin nga përkujdesja psiko-terapeutike apo nga ana e juristitëve.

Për t'u ofruar kjo ndihmë, duhet që paraprakisht të bëhet një kërkesë për miratim-pëlqimiin e mbulimit të shpenzimeve. Nga ana jonë, ne ju ndihmojmë në përpilimin e kërkesës për ndihmë për periudhë më të gjatë kohore, konform rregullave të OHG-së.

### **4. Kompenzimi dhe kompenzimi për përjetimin e dhunës**

#### **Kompenzimi**

Në kuptimin e OHG-së, kompenzimi duhet kuptuar si mbulesë e pjesërishme apo mbulim dhe kompenzim i plotë i të gjitha harxhimeve efektive që lidhen me dëmin e përjetuar nga akti i ushtrimit të dhunës.

Kompenzimi bëhet nga ana e kantonit prej nga vjen kryesi i veprës së aktit të dhunës (si edhe kompenzimi për dëmin e përjetuar shpirtëror), vetëm atëherë kur kryesi i veprës apo sigurimi përkatës nuk bëjnë pagesën e shpenzimeve apo kompenzimit.

Kompenzimi i dëmit, lidhet dhe varët nga limiti i të ardhurave të personit. Ju si viktimë, keni të drejtë të kërkonit një pagesë paraprake.

#### **Kompenzimi për përjetimin e dëmit shpirtëror**

Dëmi shpirtëror është në njëfarë forme një kompenzim i dëmit të përjetuar shpirtëror dhe paguhet pavarësisht prej të ardhurave të viktimës.

Përgjegjës për kompenzimin e këtij dëmi të përjetimit shpirtëror është institucioni i kantonit ku është kryer vepra e dhunës. Në kantonin Basel-Stadt lidhur me këtë është Enti për Ndihmë Sociale, kurse në kantonin Basel-Land është Drejtoria e Sigurisë në Liestal.

Ne ju përkrahim, në rastin kur dëshironi të shtroni një kërkesë për kompenzim material dhe për kompenzimin për dhimbjen e përjetuar shpirtërore.

#### **Vërejtje e rëndësishme:**

E drejta për kompenzim dhe kompenzim për dhimbjen e përjetuar shpirtërore, duhet të bëhet brenda kohës **prej 5 vitesh, prej se kur ka ndodhur vepra penale**, dhe kërkesa duhet të shtrohet në kantonin ku ka ndodhur vepra. Pas skadimit të këtij afati, skadon e drejta për një kërkesë të tillë (vjetërsimi i lëndës).